REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 504/20
Datë/Datum. 27/07/20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ANKESË

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për:Organin Shqyrtues të Prokurimit

Për aktivitetin e prokurimit:"Furnizim me pllomba për Doganën e Kosovës"

Nr.i Aktivitetit të prokurimit:201 13300-20-2108-1-1-1

Nr. i brendshëm: 2011.133.20.023.111

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK : ***"CAR4YOU.shpk***

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)
Vrelle – rruga e vjeter e aeroportit,Lipjan

(Adresa)

Lipjan *(Kodi postar)14000*
(Vendi)

(Numri Telefonit) ***049210 100*** *(Numri i Faks-it)*

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)Bujar Shatri

(Adresa elektronike)bujar.shatri@gmail.com

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar Car4You SH.P.K. Vrellë, Lipjan Limited Liabilities Companies

27.07.2020

(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

-Njoftimi për kontratë në KRPP është bërë me 22.05.2020,
-Afati i fundit për dorezimin ofertave ka qenë me dt.22.07.2020
-Lloji i kontratës furnizim,
-Kriter për dhënien e kontratës tenderi i përgjegjshëm qmimi më i ulët
-Kërkesa për ri-shqyrtim me dt.15..07.2020,
-Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim me dt.17.07.2020

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] **Jo** [ ]

AK-Doganat e Kosovës me dt.17.07.2020 na njoftojn me vendimin mbi refuzimin e kërkesës pë ri-shqyrtim të cilin e kemi parashtruar me dt.15.07.2020,lidhur me aktivitetin e prokurimit :"Furnizim me pllomba për Doganën e Kosovës", nr.i aktivitetit të prokurimit:201 13300-20-2108-1-1-1.Në vendimin e tyre si arsyetim AK-Doganat e Kosovës gjejnë se toleranca e prej +-1mm është e mjaftueshme dhe gjthëpërfshise,se sqarimet dhe plotësimet e DT përmbushin qëlimin e këtij aktiviteti të prokurimi.
Mbështetur në dispozitat e nenit 109 të LPP-ë parashtrojmë ankesë kundër këtij vendimi sepse AK nuk ka dhën arsye bindse se specifkikat teknikepërkatsisht dimensione të trupit të pllombes lidhur me aktivitetit e prokurimit për tenderin:"Furnizim me pllomba për

Doganën e Kosovës", nr.i aktivitetit të prokurimit:201 13300-20-2108-1-1-1. janë në pajtim me parimin e mosdiskriminimit dhe barazis në trajtim si dhe përfshirjen e konkurencës dhe gjithëpërfshirjes.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Andaj AK me rastin e refuzimit të kërkesës tonë për ri-shqyrtim si të pa bazuar dhe mos lejimin e ndryshimeve të këtyre dimenzioneve për këtë aktivitet të prokurimit të lartë cekur ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e neneve të LPP-së si më poshtë:
Nenin 1,
Neni 7,
Nenit 27,
Nenit28,
Nenin 108A të LPP-së
Neni 20 i RUOPP,

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Nga autoriteti kontraktues Doganat e Kosovës në kërkesën ton për ri-shqyrtim kemi kërkuar dimensionet e pllombës me dimensionet e kërkuara : gjatësi 2,6 cm; gjerësi 2,2 cm dhe 0,6 cm trashësi.janë në kundërshtim me nenin 28 të LPP dhe nenin 20 të RUOPP dhe kemi kërkuar që këto dimenzione të jenë +-3mm me qëllim që të ketë konkurenc dhe gjithëpërfshirje si dhe ti mundësohet edhe prodhuesve dhe OE tjerë pjesmarrje në këtë

aktivitet të prokurimit.
AK-Doganat e Kosovës në pajtim me nenin 108A të LPP-së kan pas mundësin që të bëjnë ndryshime lidhur me këto dimensione ashtu siq e lejon kjo dispozit ligjore e cila ja jep këtë të drejt AK që nga këtë faz të kompletojnë DT dhe specifikat teknike.
Nga përgjigjja e tyre të dhën në vendimin e dt.17.07.2020 AK nuk jep sqarime dhe përgjigje se dimensionet e përcaktuara janë konform LPP duke mos dhënë informacione se ka prodhues dhe OE të mjaftueshë që prodhojnë dhe furnizojnë me këto pllomba me dimesionet e kërkuara nga AK.
Nga kërkimi ynë në inernet kemi gjetë se dimensionet e kërkuara me tolerancën e lejuara nga AK +-1mm i përshtaten vetëm prodhuesit dhe OE i cili është duke realizuar kontratën paraprake në Doganat e Kosovës dhe ky prodhues është Shangai Xinfan Industries Corporation - TSS eshte pllomba e prodhuesit aktual qe e furnizon Doganen ku shihet dimensionet e sakta qe janë kërkuar në DT dhe NJPK.
Dyshimet tona se AK ka kërkuar këto dimensione vetëm me qëllim të favorizimit të OE dhe prodhuesit i cili ka kontratën me Doganat e Kosovës është evidente dhe kjo shifet nga refuzimi kategorik se toleranca lejohet vetëm +-1mm e përcaktuar e edhe me vendimin mbi refuzimin e kërkesës sonë për i-shqyrtim.
AK nuk jep sqarime dhe informacione se sa prodhues dhe OE tjerë i plotësojnë këto dimensione të kërura,nuk mjafton arsyetimi se me tolerancën +-1mm AK ka përmbush kërkesat e nenit 28 LPP dhe 20 të RUOPP.
Lidhur me atë se këto kërkesa janë përgaditur për prodhuesin dhe OE i cili është duke furnizuar doganat e Kosovës,panelit shqyrtues i diorëzojm informacione si më poshtë.

Provë:Të dhënat e prodhuesit i cili furnizon Doganën e Kosovës me pllomba.
Po ashtu gjatë kërkimit në inernet kemi gjetur edhe disa prodhues tjerë por asnjë nuk i përmbush kërkesat e AK me këto dimensione dhe nuk qëndroj arsyetimi i AK se me këto dimensione ka gjthëpërfshirje.
Provë:Të dhënat e prodhuesve tjerë i kem edhe ne tender.

Panelin Shqyrtues e nkoftojm edhe me dy qështje të rëndësishme që AK ka vepruar në kundërshtim me qëllimin e këtij aktiviteti të prokurimit.
-Në DT dhe në NJPK me rastin e publikimit nuk është kërkuar fare dimensione të plombës,këto dimensione janë vendos pas pyetjeve sqaruese ku sigurisht me insistimin e prodhuesit dhe OE i cili furnizon aktualisht Doganat e Kosovë me pllomba dhe
-Me rëndësi të veqant për natyrën e këtij aktiviteti është siguria e pllombës,AK Doganat e Kosovës duhet i kushtojnë rëndësi kësaj kërkese ashtu siq kanë kërkuar standarde ISO për këtë aktivitet të prokurimit.
Standardi ISO 17712:2013 vendos procedura standarde për klasifikim,pranim dhe tërheqje të pllombavemekanike të kamioneve dhe kontinjerve të mallrave.Ai siguron një burim të vetëm të informacionitmbi pllombat mekaniketë cilat jan të pranueshme për sigurimin e kontinjerve të mallrave në tregtin ndërkombëtare.
Nga kjo gjejmë e rëndësishme është siguria e pllombës dhe nuk janë madhësia e pllombës sepse edhe vetë Doganat e Kosovës në fillim nuk i kanë kërkuar dimenzione të pllombës sepse nuk ka se qfar madhësie janë por primare është siguria e saj.

Panelin Shqyrtues e njoftojm si më posht edhe me kërkesë tonë për ri-shqyrtim të parashtruar pran AK:

Ne si OE i interesuar për këtë aktivitet të prokurimit kemi pranuar dosjen e tenderit me

qëllim të ofertimit,nga DT dhe në veqanti specifikimet teknike kemi gjetur se dimenzionet e të trupit të pllombes jan në kundërshtim me nenin 28 të LPP dhe nenit 20 të RUOPP.
AK-Doganat e Kosovës në specifikacionet teknike ka kërkuar që trupi i pllombës duhet të ketë këto dimenzione: gjatësi 2,6 cm; gjerësi 2,2 cm dhe 0,6 cm trashësi.
Lidhur me këto dimenzione të trupit të pllombës AK i janë parashtruar kërkesa dhe pyetje sqaruese për të ndryshuar përkatsisht të caktohet një tolerancë e arsyeshme e cila do të mundësoj pjesmarrje më të gjerë të OE të interesuar dhe prodhues tjerë të cilët me këto dimesione nuk mund të ofertojnë me prodhimet e veta.
*Kufizimi me tolerancë prej +- **1mm** nuk e zgjeron konkurencë dhe nuk përket me qëllimin e prokurimit sepse dimensionet e trupit te pllombës nuk janë përcaktuese në efektin e sigurisë dhe qëllimit të këtij aktiviteti të prokurimit ,ashtuqë ne kemi kërkuar që dimensionet e trupit te pllombës të jenë +- **3mm** me qëllim të pjesmarrjesë sa më të gjerë të prodhuesve tjerë,perderisa specifikat tjera teknike te jene te njejta me ato qe ka kerkuar AK siq jane gjatesia e telit si dhe standardet e sigurise .*
AK me këtë rast ka kufizuar konkurencë dhe është përcaktuar për prodhues të caktuar nuk mund të ketë siguri në pllombë vetëm nga madhësia por ajo përcillet edhe nga elementet,pjesët përcjellëse tjera të cilat e kanë efektin dhe qëllimin e saj sidomos nga materiali i saj,metali,siguresa e tjera,madhësia e pllombës mund të jetë edhe më e vogël por edhe më e madhe se dimensionet e kërkuara dhe të ketë efektin e njejtë,nëse kemi një aprovim +-3mm në aspektin vizuel fare nuk vrehet sepse nuk kemi të bëjmë me një ndryshim në madhësi në cm por në milimetra.
Konsistenca e AK në dimenzionet e përcaktuara duke lejuar ndryshim vetëm në +-1mm na len të dyshojmë se AK është i përcaktuar për OE dhe prodhues të caktuar dhe nuk lenë hapsir për prodhues dhe OE tjerë,AK është i obliguar të mundësoj pjesmarrje sa më të gjerë të OE dhe prodhuesve tjerë që pretndojnë të ofertojnënë këtë aktivitet të prokurimit.

Nga të cekurat më lartë gjejmë se AK me rastin hartimit të DT dhe specifikat teknike dhe refuzimin e kërkesës ppr ri-shqyrtim ka bërë:

-Shkelje esenciale të dispozitave të Ligjit pët Prokurim Publik.

Se ka shkelje të dispozitave të LPP vrehet qartë sepse nuk ka lejuar gjithë përfshirje dhe mundësi OE dhe prodhuesve tjerë që nuk i kanë produktet e tyre këto dimensione lidhur me këë nenit 28.2 i LPP e qartëson shprehimisht citat:
" Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik".
Po ashtu edhe dispozitat e nenit 20.3 të RUOPP po ashtu e përkufizon dhe e detyron AK që të hartoj specifika jo diskriminuese ciat i kësaj dispozite:

"Specifikimiet teknike do të përshkruajn dhe përkufizojnë në mënyrp jo diskriminuese karakteristikat e obligueshme të objektit të kontratës siq janë të dizajnit, dimensionet, siguria, sigurimi i cilësisë, terminologjia, simbolet, testimi dhe metodat".

AK-me rastin e ri-shqyrtim nuk ka vepruar konform nenit 108A të LPP sepse AK ka të

drejtë dhe mundësi në ndryshimit të DT dhe NJPK në këtë fazë, e po ashtu ti përgjigjet dhe të jep arsyeshmëri bindëse në refuzin e kërkesës për ri-shqyrtim se cilat janë arsyet e përcaktimit për këto dimensione.

AK-Doganat e kosovë me rastin e përcaktimit të specifikave teknike ka ra ndesh po ashtu edhe me nenin 7 të LPP-së e cila dispozit e rregulon këtë qështje specifikisht citat i 4 pargrafeve të këtij neni:

"1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

Po ashtu AK është i detyruar që me alikimin e proceduarve dhe veprimet e ndërrmarra tœ rrespektoj nenin 1 të këtij Ligji i cili i detyron AK që me rastin e zhvillimit të aktivteteve të prokurimit të siguroj transparenc dhe mënyr efikase të shfrytëzimit të fondeve publike citat i nenit 1.1 të LPP:

"1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla".

Nga të cekurat më lartë gjejmë se këtë aktivitet të prokurimit e ka përcjell jo transparenca ,favorizimi dhe diskriminimi,OE kanë kërkuar që të ketë ndryshim në specifikat e kërkuara që nënkupton se nuk jemi vetëm ne që kemi kërkuar dhe kërkojm ndryshim të këtyre dimensioneve por edhe OE tjerë të cilët janë dëmtuar.

Mos ndryshimi i këtyre dimenzioneve e ri-përsërisim edhe njëher se favorizon prodhues të caktuar e që kjo përjashton konkurencën dhe tregun e lirë.

Neve si OE na shtyn të dyshojmëm se këto specifikime teknike i jep mundësi OE dhe prodhuesve që të kenë qmime të larta dhe manipulative të cilët do të përdorin këtë shansë që qmimet të mos jenë konform qmimeve reale të tregut,një mundësi të till ju ofrohet me qëllim dhe përkrahje të AK.

AK nëse është përcaktuar për prodhues të vetëm dhe të caktuar atëher është dashur të zgjedh procedurën e negocuar pa publikim të njoftimit ashtu siq rregullohet me dispozitat e nenit 35 të LPP dhe jo të përdorë procedurë të hapur e në anën tjetër të kufizoj

pjesmarrjen me specifika diskriminuese dhe favorizuese.

AK-Doganat e Kosovës duhet të kërkojnë që siguria e pllobës të jetë parsore dhe pllomba se qfar madhësie është sepse madhësia e pllobës nuk e përcakton sigurin dhe arritjen e qëllimit të kërkuar.
Andaj Paneli Shqyrtues me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese lidhur me aktivitetin e prokurimit :"Furnizim me pllomba për Doganën e Kosovës", nr.i aktivitetit të prokurimit:201 13300-20-2108-1-1-1 të merr këtë

VENDIM

1.Aprovohet si e bazuar ankesa e OE""CAR4YOU"shpk ,nga Lipjani lidhur me aktivitetin e prokurimit për tenderin:"Furnizim me pllomba për Doganën e Kosovës", nr.i aktivitetit të prokurimit:201 13300-20-2108-1-1-1.

2.Obligohet AK-Doganat e Kosovës që të ndryshoj dimensionet e pllombës dhe lejohet +-3mm prej dimenzioneve të kërkuara në DT për aktivitetin e prokurimit për tenderin:"Furnizim me pllomba për Doganën e Kosovës", nr.i aktivitetit të prokurimit:201 13300-20-2108-1-1-1 dhe lënda kthehet në ri-vlersim.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Ne konsiderojmë se dëmet materiale janë humbja e kontratës me të cilin pësojmë në aspektin financiar,
Shpenzimet e përgaditjesë së tenderit,
Sigurimi i tenderit,
Shpezimet e ankesës.
Largimi nga tregu që për ne paraqet dëm në prespektiv dhe imazh të kompanisë tonë
Fitimi i planifikuar për këtë tender

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.